



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

---

Numri i lëndës: 2020:000768

Datë: 04.12.2021

Numri i dokumentit: 02471367

**P.nr.1/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC**, Departamenti i Përgjithshëm-gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit K.M., nga G., rruga “...” nr.142 (tani gjendet në vuajtje të dënimit me burgim në Burgun e Dubravës), i akuzuar për vepër penale Vjedhja e rëndë, të parashikuar nga neni 315 par.1. nënpar.1.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti të Përgjithshëm PP.II.nr.3026/19, të dt.26.12.2019, në shqyrtimin gjyqësorë publik, të mbajtur me datë 03.12.2021 në prani të Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Menduhi Kastrati dhe të pandehurit, e në mungesën e të dëmtuarit, me datë **03.12.2021** mori dhe publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I PANDEHURI: K.M.**, i biri i Sh., dhe i S., mbiemri i saj i vajzërisë V., i lindur me *data e lindjes...*, në G., Komuna e G., ku edhe tani e ka vendbanimin rruga “...” nr.142 (tani gjendet në vuajtje të dënimit me burgim në Burgun e Dubravës në kohëzgjatje prej 1 (një) viti), me numër personal të letërnjoftimit *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i gjendjes të dobtë ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i gjykuar: 1.-me aktgjykimin e plotëfuqishëm të kësaj gjykate P.nr.293/2018, të dt.16.05.2018, me dënim më gjobë në shumë prej 500 (pesëqindë) € dhe me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim me burgë e ka vuajtur, për vepër penale Vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 327 par.1, nënpar.1.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i Vjetër dhe 2.-me aktgjykimin e plotëfuqishëm të kësaj gjykate P.nr.89/2018, të dt.07.06.2019, me dënim më gjobë në shumë prej 1.200 (njëmijë e dyqindë) € dhe me dënim të kushtëzuar me burgë, ashtu që gjykata të pandehurit ia kishte caktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe në të njëjtën kohë kishte urdhëruar që ky dënim me burgë të mos ekzekutohej nëse i pandehuri në afat prej 3 (tre) vite, nuk kryen vepër tjetër penale, për vepër penale të kryer në bashkëkryerje Vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 327 par.1, nënpar.1.1. lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i Vjetër, ndaj tij në këtë gjykatë zhvillohen procedura të tjera penale për vepra të ndryshme penale.

## ËSHTË FAJTOR

**SEPSE:** me dt.05.06.2019, rreth orës 19:35, në rrugën “...” në G., Komuna e G., në objektin banesor të përfunduar, e në përgaditje për banim, në pronësi të dëmtuarit B. P., i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër, kishte kaluar rrethojën e objektit dhe kishte depërtuar në brendësi të objektit, ku kishte marr kablo të rrymës, e cila ishte e vendosur në gypat përkatës për furnizim, dhe një pjesë e kabllit kishte qenë e shtrirë dhe e përgaditur për shpërndarjen e rrymës nga kati i parë në katin e pestë, kablo kishte qenë e dimensioneve 5x6 mm dhe 5x10 mm dhe me gjatësi 80-90 metra, në vlerë rreth 1.000 (njëmijë) Euro dhe nga aty e kishte dërguar dhe shitur në kundërvlerë prej 233.50 €, tek hekurishtja N.T.P. “Rrezi Com”, me pronar I.M. në F.,-

**-me këtë ka kryer veprë penale Vjedhja e rëndë, të parashikuar nga neni 315 par.1. nënpar.1.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

Andaj gjykata në vështrim të neneve 4,7,17,21,38,43,46,47,48,49,59,61,69,79 dhe neni 315 par.1. nënpar.1.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) si dhe neneve 450 par.3. dhe 453 par.1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i shqiptonë:

## DËNIM ME GJOBË

**Të pandehurit K.M., në shumë prej 1.200 (njëmijë e dyqindë) €, të cilin detyrohet të e paguaj në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

Nëse i pandehuri në afatin e caktuar nuk dëshironë ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgë. Kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e neni 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse i pandehuri në afatin e caktuar nuk dëshironë ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do të zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siq parashihet në paragrafin 3 të neni 43 të KPRK-së. E nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimin ndërpritet.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimin me burgë, të e zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzetë (20) € gjobë, kjo mundësi e tillë e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e neni 43 par.5. të KPRK-së.

**Koha e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej 30 (tredhjetë) ditë, dhe atë prej dt.01.07.2019 e deri me dt.30.07.2019, të pandehurit do të i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë.**

Si dhe i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

Ashtu që gjykata të pandehurit ia cakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite**, dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim me burgë të mos ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej **3 (tre) vite**, nuk kryen veprë tjetër penale.

Të pandehurit K.M., i shqiptohet **DËNIMI PLOTËSUES-Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit**, ashtu që urdhërohet i pandehuri K.M., që të dëmtuarit B.P., nga G., rruga

“...”, Komuna e G., të ia bëjë dëmshpërblimin në vlerë prej **1.000 (njëmijë) €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej **50 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Detyrohet i pandehuri që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej **30 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Pergjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.3026/19, të dt.26.12.2019, ka akuzuar të pandehurin për vepër penale Vjedhja e rëndë, të parashikuar nga neni 315 par.1. nënpar.1.1. Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor për dt.03.12.2021, ku ka ftuar dhe ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Pergjithshëm Menduhi Kastrati dhe i pandehuri. Nuk ishte i pranishëm i dëmtuari.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tija, ashtu siq e parashehë neni 323 të KPP-së. I pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet për të drejtat e tija.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar me leximin e aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, ashtu siq e parashehë neni 324 të KPP-së. Në bazë të nenit 325 të KPP-së, pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e kupton aktakuzën, të pandehurit ia ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranoj fajësinë.

Në bazë të nenit 326 par.1. të KPP-së, i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi në të gjitha pikat e aktakuzës, pastaj gjyqtari ka përcaktuar se i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, se pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë akuza dhe se akuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, të gjitha këto të parapara më nenin 248 par.1. të KPP-së.

Në bazë të nenit 326 par.2. të KPP-së, për vlerësimin e pranimi të fajësisë së të pandehurit, gjyqtari ka kërkuar mendimin e Prokurorit të Shtetit. I njëjti deklaroi se janë përmbushur kushtet nga neni 248 par.1. të KPP-së.

Në bazë të nenit 326 par.4. të KPP-së, pasi që gjyqtari ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 par.1 të KPP-së janë përmbushur, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Pergjithshëm, në fjalën e saj përfundimtare deklaroi: mbetëm pranë aktakuzës, pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, është i mbështetur në prova materiale, prova këto nga të cilat është ngritur aktakuza. Andaj vlerësoi se ky pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni edhe mbështetur mu në këto prova dhe në pajtim me vullnetin e të pandehurit. I propozoi gjykatës që me rastin e matjes së lartësisë së dënimit, pranimin e fajësisë të e marr si rrethanë lehtësuese dhe të i merr parasysh rrethanat rënduese.

I pandehuri, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e kam pranuar fajësinë, gjykatës i premtoi se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohem për veprën e kryer penale, kërkoi falje, shpreh keqardhje, e pranoi se kam gabuar, kërkoi nga gjykata që të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

Duke i vlerësuar me ndergjegje provat e nxjerrura në procedurë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, në bazë të nenit 7 par.1. dhe nenit 361 të KPP-së, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjendjen e këtillë faktike gjykata e ka

vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe nga provat dhe faktet që i përmbanë aktakuza.

Nisur nga këto fakte dhe prova të vërtetuara në procedurë, në veprimet e të pandehurit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhja e rëndë, të parashikuar nga neni 315 par.1. nënpar.1.1. Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilën e ka kryer me dashje direkte, me çka e ka dëshiruar kryerjen e kësaj vepre penale.

I pandehuri e ka kryer këtë vepër penale, sepse në bazë të nenit 7 të KPRK-së, kjo vepër penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparët e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Për këtë vepër penale është shpallur fajtor, sepse në përputhje me nenin 17 par.1 të KPRK-së thuhet se "kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia". Në rastin konkret i pandehuri këtë vepër penale e ka kryer me dashje direkte sipas nenit 21 par.2. të KPRK-së, ku është paraparë sanksioni penal.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të pandehurin, pati parasysh te gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të pandehurin merr faktin se e ka pranuar fajësinë në tërësi, se ka premtuar se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, se është penduar për veprën e kryer penale, se kërkon falje dhe shpreh keqardhje, ndërsa rrethana rënduese gjeti shkallën e lartë të dashjës gjatë kryerjes së kësaj vepre penale nga ana e të pandehurit dhe se më parë është i gjykuar me burgim për vepër të njëjtë penale. Andaj edhe pse për këtë vepër penale është i paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre vite e deri në shtatë vite, të njëjtit ia shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 1.200 (njëmijë e dyqindë) €, si dhe ia shqiptoi dënimin me kushtë, duke vlerësuar se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit me burgim është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryej vepër penale, duke u bazuar në nenin 47 të KPRK-së, duke ia caktuar dënimin me burgë në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, dhe në të njëjtën kohë urdhëroi që ky dënim me burgë të mos ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 3 (tre) vite, nuk kryen vepër tjetër penale, me bindjen se dënimi me gjobë si dhe me burgë i kushtëzuar është ne perputhshmeri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësin penale të të pandehurit dhe se i njëjti dënim do të ndikoi që të parandaloi të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarit për dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimin që koha e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej 30 (tredhjetë) ditë, dhe atë prej dt.01.07.2019 e deri me dt.30.07.2019, të pandehurit të i llogaritët në dënimin e shqiptuar me gjobë, gjykata e bazoi në nenin 79 par.1. të KPRK-së.

Vendimin që të pandehurit K.M., të i shqiptohet dënimi plotësues-Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit, ashtu që urdhërohet i pandehuri K.M., që të dëmtuarit B.P., nga G., rruga "...", Komuna e G., të ia bëjë dëmshpërblimin në vlerë prej 1.000 (njëmijë) €, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbartimit me dhunë, gjykata e bazoi në nenin 59 të KPRK-së (ku përcaktohet se dënimi plotësues mund të shqiptohet së bashku me dënimin kryesor ose alternativë), e lidhur me nenin 61 par.1. të KPRK-së (ku përcaktohet se kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo vepre penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhëroi kryesin që të bëjë dëmshpërbilimin e viktimës së veprës penale).

Vendimin mbi paushallin gjyqësorë, gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 par.3. të KPP-së, ashtu që lartësia e paushallit gjyqësorë në shumë prej 50 €, u caktua duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmerin e procedurës penale si dhe gjendjen financiare të të pandehurit.

Vendimin që të detyrohet i pandehuri që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 30 €, gjykata e bazoi në nenin 39 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr.05/L-036 për Kompenzimin e Viktimave të Krimit (ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nënparagafët 3.1. dhe 3.2. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej tredhjetë (30) €, i cili ligj me datën.28.05.2015 ka hyrë në fuqi, e për të cilin Gjykata Supreme e Kosovës me Qarkoren nr.35/2018, të dt.30.01.2018, për zbatimin e të Ligjit nr.05/L-036 për Kompenzimin e Viktimave të Krimit ka kërkuar nga gjykatat që të zbatojnë këtë dispozitë ligjore për të e paguar taksën e lartëtheksuar

Nga e lartëtheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr.1/2020, datë:03.12.2021**

**Procesmbajtësja  
Elheme Kastrati**

**G j y q t a r i  
Shefqet Baleci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Në bazë të nenit 368 par.1. të KPP-së, pas shpalljës së aktgjykimit gjyqtari i ka udhëzuar palët për të drejtën në ankesë, e cila mundë të paraqitet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjës së aktgjykimit dhe atë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në tre kopje.

Në bazë të nenit 380 par.2. të KPP-së, ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar si më lartë, e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit.

.